

VENDIM
Nr. 34, datë 2.5.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe neni 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59, pikat 2 dhe 3, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në nenin 6, pika 2 dhe pika 3 shfuqizohen;
- b) Në aneksin 7, formulari 9 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme.

RMK – Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

1)

Treguesit	Vlera
Kapitali rregullator	(a)
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(b)
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (në %)	(a)/(b)*100

2)

Treguesit	Vlera
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(d) = (a)+(b)+(c)
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	(a)
12.5*kërkesa për kapital për rrezikun e tregut	(b)
12.5*kërkesa për kapital për rrezikun operacional	(c)

c) Aneksi 8 shfuqizohet.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko